



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:327/25, Data:02.04.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 135 të mbajtur më 10.03.2025 dhe vazhdimet të datës 18.03.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet Kolegji Rezonanca në nivel institucional, për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030).
- II.** Obligohet Kolegji Rezonanca që deri me 30 shtator 2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim planin për zbatim të rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji Rezonanca ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.1491/24, datë 31.07.2024, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA) për riakreditim në nivel institucional.

AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Rezonanca me qëllim të vlerësimit në nivel institucional. Vizita është organizuar me datë 18.11.2024, me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Olgun Cicek dhe Domagoj Svigir.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit) ekipi i vlerësuesve të jashtëm të

akreditimit (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit dhe nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Kolegji Rezonanca është vlerësuar se përmbushë: Plotësisht dhjetë (10) fusha të standardeve dhe Substancialisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.

Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka rekomanduar që Kolegji Rezonanca të riakreditohet për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 1 tetor 2025 - 30 shtator 2030.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në vazhdimin e mbledhjes 135, të mbajtur me datë 18.03.2025, ka shqyrtuar kërkesën e Kolegjit Rezonanca dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së.*

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi ju dërgohet :

- Kolegji Rezonanca
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.